



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2023

VENDIM

Nr. 490, datë 14.11.2022

**PËR
KUALIFIKIMIN E KANDIDATIT Z. {...},
PËR NË FORMIMIN FILLESTAR NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS,
PËR MAGJISTRAT, PROFILI GJYQATAR, PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 14.11.2022, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për emërim si magjistrat, profili gjyqtar, të kandidatit z. {...}”, përgatitur nga relatori z. Klodian Kurushi, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin e kandidatit z. {...} për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, në vitin akademik 2022-2023,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Z. {...} është kandidat për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, profili gjyqtar, në kushtet kur:

a) është vlerësuar nga Shkolla e Magjistraturës, në bazë të Raportit të Vlerësimit Përfundimtar të datës 06.04.2022, se plotëson kriteret e pranimit në formimin fillestar për magjistrat sipas nenit 28 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin);

b) ka marrë pjesë në provimin e organizuar nga Shkolla e Magjistraturës sipas nenit 31 të Ligjit të Statusit dhe është përfshirë në listën e renditjes së kandidatëve fitues në formimin fillestar

për magjistrat, profili gjyqtar, përcjellë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me Shkresën nr. 413/1 prot., datë 19.05.2021 (protokolluar në Këshill me aktin nr. 2903 prot., datë 20.05.2022).

2. Me Vendimin nr. 197, datë 27.05.2022, mbështetur në nenin 32 të Ligjit për Statusin, si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), i ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur *fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar për magjistratë, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2022-2023*, duke caktuar relatorin për çdo procedurë verifikimi për secilin kandidat, ku në bazë të shortit, për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit *për kandidatin z. {...} si relator u caktua z. Klodian Kurushi*.

3. Më datë 27.05.2022, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidati, z. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua:

- për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit;
- për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi;
- për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

Po ashtu, kandidati u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

4. Brenda afatit treditor, kandidati, z. {...}, depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidati nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5. Më datë 31.05.2022, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidatit, z. {...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

6. Brenda afatit të caktuar, kandidati, z. {...}, depozitoi formularët dhe autorizimet përkatëse, (sipas pikës 4, Seksioni A, Kreu IX, të Vendimit 75/2019), si dhe dorëzoi rregullisht edhe formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave private e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI).

7. Në vijim të procedurës së verifikimit, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, përcaktuar në nenin 32 të Ligjit të Statusit, për kandidatët për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, ndër ta edhe për z. {...}.

8. Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

9. Gjatë procedurës së verifikimit, mbështetur në të dhënat e deklaruara nga vetë kandidati në jetëshkrimin e depozituar në rastin e aplikimit pranë Shkollës së Magjistraturës, në lidhje me eksperiencën e tij në punë (punësimin), si dhe në ato të marra nga organet e sigurimeve shoqërore (me Shkresën nr. 4114/1 prot., datë 20.06.2022, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore; me Shkresën nr. 5846 prot., datë 24.06.2022, të Drejtorisë së Arkivit Qendror/Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion nga subjektet që kanë mbikëqyrur disiplinën në punë të kandidatit z. {...}, të cilët kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

10. Pas administrimit të dokumentacionit të nevojshëm, duke çmuar se procedura e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin {...}, ishte e plotë dhe në përputhje me kërkesat e Vendimit 75/2019, më datë 18.10.2022, relatori e parashtrori çështjen përpara Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

11. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës e shqyrtoi çështjen më datë 18.10.2022 dhe, pasi vlerësoi të plotë procedurën e verifikimit në këtë rast, bazuar në pikën 3, Seksioni C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, vendosi kalimin e tij për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për kualifikimin ose skualifikimin e kandidatit {...} për në formimin fillestar për magjistrat (profili gjyqtar) në Shkollën e Magjistraturës.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PËR KRITERET E PRANIMIT NË FORMIMIN FILLESTAR TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

A. Për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat

12. Sa i përket kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, përfshirë edhe për kandidatin {...}, si dhe më lart u parashtrua, vlerësimi për plotësimin e tyre është bërë, në momentin e kandidimit, nga ana e

Shkollës së Magjistraturës, bazuar kjo në nenin 30¹ (“Kandidimi dhe vlerësimi paraprak i kandidatëve”) të Ligjit të Statusit. Në përfundim të vlerësimit, Shkolla ka përgatitur dhe i ka paraqitur Këshillit të Lartë Gjyqësor raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak së bashku me dosjet me dokumentet e kandidimit për secilin kandidat, ku pas komenteve të Këshillit, më datë 06.04.2022, Shkolla ka miratuar dhe publikuar në faqen e saj zyrtare Raportin e Vlerësimit Përfundimtar, përfshirë dhe listën e kandidatëve, të cilët plotësonin kriteret e parashikuara në nenin 28 të Ligjit të Statusit. Në këtë listë është përfshirë dhe kandidati {...}.

13. Gjithsesi, për kandidatin {...}, u konsiderua verifikimi sërish i disa prej kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magistrat, përcaktuar në nenin 28 të Ligjit të Statusit.

13.1 Për këtë u mbajt në konsideratë diferenca kohore mes momentit të aplikimit të kandidatëve (Shkurt 2022), momentit të vlerësimit përfundimtar nga Shkolla e Magjistraturës për plotësimin e kriterëve nga ana e tyre (Prill 2022), si dhe momentit aktual, kur Këshilli duhet të shprehet për kualifikimin ose jo të kandidatëve për në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, të cilët kanë rezultuar fitues në provimin e pranimit (shtator 2022). Dhe po ashtu, nga ana tjetër, u mbajt në konsideratë dhe fakti se shumica e kriterëve të pranimit në formimin fillestar janë potencialisht të ndryshueshëm në kohë (me përjashtim të kriterit arsimor, kriterit të përvojës profesionale, kriterit të anëtarësisë në parti politike, në kohën e kandidimit dhe kriterit të anëtarësisë, bashkëpunëtorit ose të favorizuarit nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990).

13.2 Gjithashtu, për këtë u mbajt në konsideratë se një verifikim i tillë është detyrim ligjor për Këshillin e Lartë Gjyqësor që buron nga neni 32 (“Verifikimi i pasurisë dhe figurës”), pika 4/1², shkronja “ç”, të Ligjit të Statusit, sipas të cilit Këshilli ka detyrimin të verifikojë ekzistencën e çdo shkakut përjashtues (të parashikuar nga ligji) nga kandidimi për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës. Përveç kësaj, u mbajt në konsideratë detyrimi i Këshillit për verifikimin e

¹ “1. Shkolla e Magjistraturës pranon aplikimet për pranimin në formimin fillestar, deri në fund të muajit shkurt të çdo viti. 2. Kandidatët paraqesin dokumentacionin e nevojshëm që vërteton përmbushjen e kriterëve të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton plotësisht përmbushjen e kriterëve, nuk është i plotë, i saktë, ose ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e tij, Shkolla e Magjistraturës mund të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë nga organet publike ose punëdhënësit e kandidatit. 3. Deri në datën 15 mars të çdo viti, Shkolla e Magjistraturës kryen një vlerësim paraprak, nëse kandidati përmbush kriteret e kandidimit, të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji. 4. Shkolla e Magjistraturës i paraqet Këshillave raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak së bashku me dosjet me dokumentet e kandidimit për secilin kandidat. Këshillat mund të japin komente ose kundërshtime jo më vonë se në fund të muajit mars të çdo viti. Shkolla e Magjistraturës miraton raportin e vlerësimit përfundimtar, duke marrë në konsideratë komentet dhe kundërshtimet e bëra, dhe publikon raportin e vlerësimit përfundimtar në faqen e saj zyrtare, duke përfshirë listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 28 të këtij. 5. Çdo kandidat, i cili nuk është përfshirë në listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret, ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore të ankimit, të parashikuara në ligjin “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe aktet nënligjore përkatëse”.

² “4/1. Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës kur: ...; ç) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit”.

kritereve të zgjedhshmërisë, të cilat janë njëherazi edhe kriteret e pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, pra ato sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit, është një detyrim konstant i Këshillit qoftë në momentin e emërimit të të diplomuarve për magjistrat (profili gjyqtar) në Shkollën e Magjistraturës, ashtu edhe gjatë karrierës së tyre si magjistrat (gjyqtar), referuar për këtë në nenet 35, 64 dhe 66 të Ligjit të Statusit.

14. Konkretisht, për kandidatin u verifikua:

a) *zotësia e plotë për të vepruar*. Për kandidatin nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë;

b) *shtetësia shqiptare*. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar dokumentin “letërnjoftim”, lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 17.12.2020, në të cilin përbërësi i gjendjes civile “shtetësia”, pasqyrohet “shqiptare”, ndërkohë që gjatë verifikimit për kandidatin nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen e shtetësisë shqiptare. Gjithashtu, nga verifikimi i bërë, më datë 22.06.2022, në regjistrin kombëtar elektronik të gjendjes civile të administruar nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile), sipas certifikatës personale elektronike të printuar në letër nga nëpunësi i ngarkuar i Këshillit, konstatohet se kandidati vijon të ketë shtetësinë shqiptare;

c) *gjendja gjyqësore*. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kjo e fundit ka kryer verifikim në regjistrin elektronik gjyqësor të administruar nga Ministria e Drejtësisë (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve) duke printuar në letër Certifikatë Elektronike datë 08.02.2022, ndërkohë që gjatë verifikimit, në kuadër të verifikimit të figurës së kandidatit, u administrua Shkresa nr. 7230/1 prot., datë 15.06.2022, e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore). Sipas këtyre dokumenteve, kandidati nuk ka shënime në sistem;

ç) *disiplina në punë*. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës kandidati ka depozituar dokumentin “Librezë Pune”, lëshuar më shtator 2017³, ndërkohë që gjatë verifikimit u administruan Shkresa nr. 2731/1 prot. datë 21.06.2022, e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ; Shkresa nr. 11436/1 prot. datë 23.06.2022 e Bashkisë Lezhë. Sipas këtyre dokumenteve kandidati nuk është e larguar nga puna për shkaqe disiplinore apo ai nuk ka masë disiplinore në fuqi; Lidhur me punëdhënësit e tjerë, personi fizik Vasil {...} nuk është arritur të kontaktohet në adresën e ushtrimit të aktivitetit sipas Qendrës Kombëtare të Biznesit; ndërsa dhe Oltjona Bregu rezulton me aktivitet të pezulluar.⁴

³ Punëdhënësi i parë, personi fizik Vasil {...} tetor 2014-shkurt 2017 nuk rezulton që ta ketë pajisur me librezë pune.

⁴ Vasil {...}-Person fizik, identifikuar me numër NIPT L32006011R, në adresën e ushtrimit të aktivitetit të deklaruar rezulton një biznes tjetër dhe shkresa është kthyer nga shërbimi postar. Në shpjegimet e tij kandidati sqaron se: “...Faktikisht ish-punëdhënësi im e ka mbyllur biznesin në adresën që ka pasur në Lagjen “Nënë Tereza” Lezhë dhe nuk kam dijeni nëse ka ndonjë adresë tjetër ku është zhvendosur. Aktualisht në adresën ku unë kam punuar pranë këtij subjekti tregtar në Lagjen “Nënë Tereza” Lezhë është hapur një biznes tjetër servis makinash. Pranë këtij subjekti kam kryer punën e shitësit. Objekti i këtij biznesi ka qenë tregtia me pakicë e pajisjeve të peshkimit dhe puna që unë kam kryer ka qenë ajo e shitësit.” Personi fizik Oltjona Bregu, rezulton me aktivitet të pezulluar. (Bar –restorant).

d) mosqenia bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar një deklaratë në 09.02.2022 në të cilën deklaroi se nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete, ndërkohë që gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për qenien e kandidatit bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

15. Për kriteret e tjera të pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës u konsiderua vlerësimi i bërë nga kjo e fundit dhe konkretisht për:

a) pasjen e kriterit arsimor. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar dokumentet:

- “Diplomë Bachelor në Drejtësi”, lëshuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, si dhe Certifikatë Notash datë 18.07.2011;

- Diplomë “Maste i Shkencave në Drejtë Civile” lëshuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë dhe vërtetim notash, diplomuar më 11.07.2013.

b) pasjen e përvojës profesionale. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës kandidati ka depozituar dokumentin “Librezë Punë”, sipas të cilës kandidati, pas përfundimit të studimeve universitare në drejtësi, ka përvojë profesionale aktive në administratën publike me kohë të plotë, në profesionin “specialist/jurist” për periudhën shtator 2017 –shtator 2020 njësi administrative e Bashkinë Lezhë dhe këshilltar kabineti dhe Drejtor i Drejtorisë Juridike në periudhën tetor 2020 e në vijim;

c) mos anëtarësinë në parti politike në kohën e kandidimit. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar një deklaratë në 09.02.2022, në të cilën deklaroi se nuk është anëtar i ndonjë partie politike;

ç) mosqenien anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990. Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar një deklaratë në shkurt 2022 në të cilën deklaroi se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990, përveç se referuar moshës së tij (datëlindja 25.10.1989), ai nuk mund të ketë qenë i tillë.

16. Nga sa rezulton nga verifikimi, kandidati z. {...} plotëson kriteret e kandidimit si gjyqtar, sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit.

B. Për kriterin e pasurisë

17. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, sipas të cilës: *“1. Kandidatët me rezultatet më të larta në listën e publikuar, sipas përcaktimeve të nenit 31, të këtij ligji, të cilët mund të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, i nënshtrohen verifikimit të plotë të pasurisë ...”*.

18. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...}, u kërkua raportim nga institucionet publike kompetente të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit. Ky raportim, krahas kandidatit u kërkua edhe për bashkëshorten e tij, **znj. Sulltane**{...}, në kushtet kur ajo është “person i lidhur” në kuptim të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar (nenet 3 dhe 5), si dhe Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (neni 2).

19. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...}, u kërkua raportim nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin nr. 798/24 prot., datë 06.09.2022.

19.1 Sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, kandidati {...} ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë dhe interesave privatë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

19.2 Po ashtu, sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit është kryer kontrolli i plotë për pasuritë, asetet dhe interesat privatë të deklaruara nga kandidati {...}, duke konkluduar se për kandidatin:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklaram të rremë;
- e) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

20. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...} u kërkua informacion Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

20.1 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informacioni u dërgua me Shkresën nr. 16432/1 prot., datë 07.07.2022, ku për kandidatin {...} nuk jepen të dhëna për aktivitet tregtar.

20.2 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me Shkresën nr. 11278/1 prot., datë 29.06.2022, ku për kandidatin {...} nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

21. Të dhënat e dërguara përmes informacioneve respektive nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, por edhe institucionet e tjera të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, u ballafaquan me të dhënat sipas Raportit të ILDKPKI-së, duke u vlerësuar se nuk kishte vend për t'iu kërkuar kësaj të fundit bërja e një kontrolli dhe raportimi shtesë.

22. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kandidatin {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit të tij, patur parasysh për këtë përcaktimin e shkronjës “a”, pika 4/1, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, sipas të cilit: *“4/1. Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të pasurisë ... kur: a) burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete duke i fshehur ato, ose në mënyrë të qëllimshme ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve, ose kandidati gjendet në situatën e konfliktit të interesit; ...”*.

Konkretisht verifikohet që:

- a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë;
- b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) kandidati ka burime financiare për të justifikuar pasuritë e tij;
- ç) deklarimi nga kandidati i pasurisë, aseteve ose interesave private, të detyrueshme për t'u deklaruar, është i plotë, i vërtetë dhe i saktë.

C. Për kriterin e figurës

23. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, sipas të cilës: *“1. Kandidatët me rezultatet më të larta në listën e publikuar, sipas përcaktimeve të nenit 31, të këtij ligji, të cilët mund të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, i nënshtrohen verifikimit të plotë të ... figurës”*.

24. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {...}, u kërkuar raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

25. Mbi kërkesën e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Prokuroria e Përgjithshme ka kryer verifikimin përkatës në të gjitha prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm në Republikën e Shqipërisë, duke përcjellë në Këshill, me Shkresën nr. 827/24 prot., datë 28.09.2022, protokolluar me aktin nr. 3438/1, datë 29.09.2022, përgjigjet zyrtare të 22 (njëzet e dy) prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë. Gjithashtu, u administrua dhe përgjigja e

Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përcjellë me Shkresën nr. 8444/1 prot., datë 05.10.2022, protokolluar në Këshill me aktin nr. 5116/1, datë 06.10.2022. Referuar përmbajtjes së këtyre përgjigjeve nuk rezulton se për kandidatin {...}, të jetë regjistruar ndonjë kallëzim penal. Nuk rezulton që ai të ketë qenë ose të jetë nën hetim, që ndaj tij të jetë caktuar ndonjë masë sigurimi ose që ai të jetë dënuar me vendim jopërfundimtar apo të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale.

26. Po ashtu, mbi kërkesën e Këshillit të Lartë Gjyqësor, u administruan shkresat përkatëse nga gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së parë dhe të apeleve; Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Gjykata e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar si edhe Gjykata e Lartë. Referuar përmbajtjes së këtyre përgjigjeve rezulton se për kandidatin {...}, nuk ka të dhëna për procedim penal të mos filluar, për procedime penale të pushuara apo të pezulluara, vendime dënimi apo pafajësie në të cilat përmendet emri i tij; nuk rezulton që të ketë marrë cilësinë e personit nën hetim në një procedim penal apo ndaj tij të jetë marrë vendim për të zbatuar/revokuar/shuar një masë sigurimi me karakter personal ose pasuror.

27. Për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {...}, atij iu kërkua dhe plotësoi e depozitoi rregullisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 02.06.2022, formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe autorizimin për Këshillin që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, të të dhënave të tij në lidhje me figurën dhe integritetin.

28. Po në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, me Shkresën nr. 7759/1 prot., datë 25.07.2022, ka dërguar të dhënat për përbërësit e gjendjes civile edhe për kandidatin {...}, pas verifikimeve të bëra në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 dhe në zyrat përkatëse të gjendjes civile.

29. Bazuar në informacionin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore) sipas shkronjës “c”, pika 12, e këtij relacioni, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, nëpunësi përgjegjës i strukturës së posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi kreu verifikimet e rastit, nuk konstatoi mangësi në të dhënat e deklaruara nga kandidati {...} në formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, duke konkluduar se kandidati: - *ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit më datë 02.06.2022*; - *formulari është regjistruar me numrin unik 000605*; - *vetëdeklarimi është bërë publik, në faqen zyrtare web të KLGJ-së*; - *në formular, nuk ka deklaruar ndryshime*; - *nga përgjigjet e ardhura nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile, nuk kanë rezultuar ndryshime të të*

dhënave të gjendjes civile apo gjendjes gjyqësore; - deri më sot nuk kemi pasur indicie apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme”. Për pasojë, u vlerësua që nuk kishte vend për verifikim shtesë nga Prokuroria e Përgjithshme.

30. Nga informacioni i ardhur nga Byroja Kombëtare e Hetimit me shkresën nr. 337/1 prot. datë 04.07.2022, në përgjigje të kërkesës së Këshillit, rezulton se për kandidatin {...} nuk ka informacion.

31. Gjithashtu, nga raportimet e shërbimeve shtetërore informative nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidatit {...} me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e tij në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme.

32. Sa sipër, nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidatin {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit të tij, patur parasysh përcaktimet e shkronjave “b” dhe “c”, pika 4/1, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, sipas të cilave: *“4/1. Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të .. figurës kur: ...; b) kandidati ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar; c) ka shfaqur sjellje të rënda të papërshtatshme etike dhe morale që cenojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë; ...”.*

Konkretisht, për kandidatin u verifikua që:

- a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015;
- b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkuara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e tij;
- c) për kandidatin nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar;
- ç) për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar;
- d) për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë ose të jetë, bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës;

dh) për kandidatin nuk ka ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me sjelljen etike dhe morale të tij, mbi të cilën të ngrihen dyshime për cenim të besimit publik në sistemin gjyqësor dhe, për rrjedhojë, mbi pranueshmërinë e tij për në formimin fillestar për magistrat në Shkollën e Magjistraturës.

III. KONKLUZIONE

33. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kriterëve ligjorë të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

34. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kriterëve ligjorë të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati përmbush këto kritere, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e tij. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidatit për në formimin fillestar për magistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2022-2023.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 32, pika 5, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 61, pika 1, në nenin 86, shkronja “ë” dhe në nenin 97, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun VI, Seksioni Ç, pika 12, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjorë për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Kualifikimin e kandidatit z. {...}, për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magistrat, profili gjyqtar, në vitin akademik 2022-2023.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik

në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR